

Broshurë teknike

# VS-W

## Lustër mbrojtëse transparente prej akriliku, me bazë uji, me strukturë nanomolekulare

### Përshkrimi

VS-W është një lustër prej akriliku me bazë uji, e gatshme për përdorim, me strukturë nanomolekulare, e cila përdoret për mbrojtjen e nënshtresave çimentoze (prej betoni, veshje dekorative të mikroçimentoze, etj.).

- Ajo përmirëson ngjyrën natyrale të materialit duke i siguruar atij një shtresë përfundimtare të bukur dhe me shkëlqim.
- Është e qëndrueshme nën rrezatimin UV; nuk zverdhet me kalimin e kohës.
- Nuk përmban tretës dhe është pa erë, prandaj është ideale për hapësira jo të ajrosura sa duhet.
- Është e përshtatshme si për përdorim të brendshëm ashtu edhe të jashtëm.

### Fushat e përdorimit

VS-W nxjerr në pah ngjyrën natyrale të materialit mbi të cilin aplikohet, duke e mbrojtur atë në të njëjtën kohë nga ndotja atmosferike. Ajo është e përshtatshme për aplikim në nënshtresa çimentoze, të tilla si shtresa dekorative mikroçimentoze, si dhe përpara aplikimit të lustrave prej poliuretani. Aplikohet në mure dhe dysheme, në ambiente të brendshme ose të jashtme.

### Të dhënat teknike

Ngjyra:	transparent (mbas tharjes)
Densiteti:	0,98 kg/litër
Tharja në prekje:	20±5 min
Koha e riaplikimit:	3-4 orë
Viskoziteti: (DIN 53211-70, 2 mm, 23°C)	100±10 sekonda
Niveli i shkëlqimit: (EN ISO 2813-99, 20°C)	> 60%
Përmbajtja e ngurtë sipas peshës: (EN ISO 3251-03)	26±2 %

**Pastrimi i veglave:** Hiqni sa më shumë material nga veglat e punës përpara pastrimit. Pastrojini krejtësisht veglat me ujë dhe sapun menjëherë pas përdorimit.

### Mënyra e përdorimit

#### 1. Përgatitja e nënshtresës

Nënshtresa duhet të jetë e thatë, e pastër, pa vajra, pluhura, grimca të lirshme, pluhur, etj.

#### 2. Zbatimi

VS-W rallohet me ujë në raport 1:1 nga volumi dhe pastaj aplikohet me furçë ose rul në dy duar. Dora e dytë jepet pasi të jetë tharë dora e parë, në varësi me kushtet e motit.

### Konsumi

150-200 ml/m<sup>2</sup> për shtresë, në varësi të aftësisë thithëse të sipërfaqes.

### Amballazhimi

VS-W ofrohet në kuti metalike 1, 5 dhe 20 litra.

### Magaznimi

Të paktën 24 muaj nga data e prodhimit në thasë të mbyllur, në temperatura ndërmjet +5°C and +35°C në vende të mbrojtura nga drita e diellit dhe ngrica.

### Shënime

- Temperatura gjatë aplikimit të produktit duhet të jetë ndërmjet + 5°C dhe +35°C.
- Ju lutemi lexoni udhëzimet e sigurisë të shkruara në paketim përpara përdorimit.

### Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)

Sipas Direktivës 2004/42/KE (Shtojca II, tabela A), përmbajtja maksimale e lejuar e VOC-së për produktin e nënkategorisë "i", lloji SB është 140 g/l (2010) për produktin e gatshëm për përdorim. Produkti i gatshëm për përdorim VS-W përmban maksimum 16 g/l VOC.